

VENDIM
Nr.531, datë 22.11.1999

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.579, DATË 8.9.1998 “PËR CAKTIMIN E RRGULLAVE PËR KTHIMIN E VLERAVE FINANCIARE KREDITORËVE, QË KANË DEPOZITUAR KAPITALET E TYRE PRANË SHOQËRIVE HUAMARRËSE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 8, pika 3 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankare, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave:

VENDOSI:

1.Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.579, datë 8.9.1998 bëhen këto shtesa:

Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“Personit, që shpallet debitor në shoqërinë huamarrëse në administrimin, e që njëkohësisht edhe kreditor, i lind e drejta të kërkojë pranë administratorëve të shoqërisë, kompensimin e detyrimit debitor me atë kreditor.

Kompensimi i detyrimeve sipas parashikimeve të kësaj pike, bëhet në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Civil.

Kur shuma e detyrimit kreditor, detyrimit për kthim, korrektuar me koeficientin pjesor, është më e madhe ose e barabartë me detyrimin debitor, administratori kryen veprimin e kompensimit në pakësim të detyrimit për kthim si dhe merr vendimin e shlyerjes së detyrimit debitor. Kur shuma e detyrimit kreditor, korrektuar me koeficientin pjesor, është më e vogël se detyrimi debitor administratori vendos për diferencën e vlerës që do të kthejë debitori.”.

2.Në pikën 6, pas paragrafit të parë, shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“Për shoqëritë huamarrëse në administrim, në përfundim të shitjes së aseteve, koeficienti i kthimit të shumave llogaritet edhe në mënyrë pjesore, si raport i të ardhurave nga shitja dhe shumës së detyrimit të mbetur, që shoqëria ka ndaj kreditorëve.

Grupi Mbikëqyrjes, në mbështetje të vendimit të administratorëve të përbashkët, i paraqet Këshillit të Ministrave, për miratim fillimin e procesit të kompensimit të pjesshëm kreditorëve, me të ardhurat e depozituara në bankë të përfituara nga shitja e aseteve”.

1.Pas pikës 9 shtohet pika 9/1 me këtë përmbajtje:

“Fondet financiare dhe burimet për mbulimin e shpenzimeve, që do të kryhen nga Banka e Kursimeve, gjatë procesit të rishpërndarjes së vlerave financiare kreditorëve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

2.Ngarkohen Ministria e Financave, Banka e Kursimeve, Grupi i Mbikëqyrjes dhe administratorët e përbashkët për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta